



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 734/3 Prot

Tiranë, më 22.09.2021

**V E N D I M**

Nr.112, datë 22.09.2021

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Finiq, të filluar me urdhrin nr. 49 (nr. 733 prot.), datë 07.07.2021, të Komisionerit në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, në këtë subjekt”.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Finiq,

**VËREJ SE,**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me urdhrin nr. 49 (nr. 733 prot.), datë 07.07.2021, “Për verifikimin e rasteve të emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Sarandë dhe në Bashkinë Finiq”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në Bashkinë Finiq.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka

rezultuar se, Bashkia Finiq, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2021, me aktin e Kryetarit të Bashkisë, Urdhër nr. 23/3 (451/3 prot), datë 01.07.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve të strukturës organizative të Bashkisë Finiq”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 76, datë 29.12.2020 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Finiq dhe Njësive Administrative, për vitin 2021”. Kjo strukturë është miratuar në drejtim të përputhjes me ligjin, nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me aktin nr. 31/1, datë 21.01.2021 dhe vazhdon të jetë në fuqi edhe në momentin e verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Finiq ka **204** pozicione pune nga të cilat **57** prej tyre konsiderohen si pjesë e shërbimit civil. Sipas kategorive të shërbimit civil këto pozicione klasifikohen në këtë mënyrë: **1** pozicion i kategorisë së lartë drejtuese, **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **7** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **39** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **20** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **28** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues ndërsa **9** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, duke specifikuar pozicionin e punës dhe punonjësin që kryen aktualisht detyrën, si edhe aktin e emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, emëruar me urdhërin nr. 258, datë 06.10.2020;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Financës”, emëruar me urdhërin nr. 125 datë 22.08.2016;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative”, emëruar me urdhërin nr. 169 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Inspektor në Inspektoriatin tatimor dhe kundravajtjeve administrative, menaxhimi i debitit, konfiskimi dhe sekuestrimi”, emëruar me urdhërin nr. 139 datë 21.11.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Administrator Shoqëror në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Shëndetësore, Rinisë dhe Sporteve”, emëruar me urdhërin nr. 117 datë 14.06.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Administrator Shoqëror në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Shëndetësore, Rinisë dhe Sporteve”, emëruar me urdhërin nr. 109 datë 30.06.2020;

- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist i Kujdesit për Shëndetin Publik në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Shëndetësore, Rinisë dhe Sporteve*”, emëruar me urdhërin nr. 112 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist Arsimit në Drejtorinë e Zhvillimit të Identitetit Etnik, Arsimit, Kulturës, Turizmit*”, emëruar me urdhërin nr. 130 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave*”, emëruar me urdhërin nr. 133 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike*”, emëruar me urdhërin nr. 128 datë 01.07.2021;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike*”, emëruar me urdhërin nr. 104 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor në Inspektoriatin tatimor dhe kundravajtjeve administrative, menaxhimi i debitit, konfiskimi dhe sekuestrimi*”, emëruar me urdhërin nr. 105 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist i Barazisë Gjimore në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Shëndetësore, Rinisë dhe Sporteve*”, emëruar me urdhërin nr. 108 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist i Menaxhimit të Tokës pranë Sektorit të AMT në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave*”, emëruar me urdhërin nr. 139 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist Prokurimesh në Drejtorinë Juridike dhe Trajtimin Ligjor të Pronave*”, emëruar me urdhërin nr. 283 datë 30.10.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist në Njësinë e Integritetit dhe Koordinimit të Programeve Europiane*”, emëruar me urdhërin nr. 245 datë 14.09.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist Topograf në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, emëruar me urdhërin nr. 226 datë 27.07.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit të Identitetit Etnik, Arsimit, Kulturës, Turizmit*”, emëruar me urdhërin nr. 261 datë 13.10.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arsimit, Kulturës dhe Turizmit në Drejtorinë e Zhvillimit të Identitetit Etnik, Arsimit, Kulturës, Turizmit*”, emëruar me urdhërin nr. 130 datë 30.06.2020;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist i Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Sektorit të AMT në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave*”, emëruar me urdhërin nr. 76 datë 31.03.2021;
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist i Kulturës dhe Zhvillimit Etnik në Sektorin e Arsimit, Kulturës dhe Turizmit në Drejtorinë e Zhvillimit të Identitetit Etnik, Arsimit, Kulturës, Turizmit*”, emëruar me urdhërin nr. 91 datë 17.05.2021;

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Njësinë e Integritit dhe Koordinimit të Programeve Europiane”, emëruar me urdhërin nr. 100 datë 24.05.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist Arkivi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, emëruar me urdhërin nr. 126 datë 01.07.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike”, emëruar me urdhërin nr. 127 datë 01.07.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist në Njësinë e Integritit dhe Koordinimit të Programeve Europiane”, emëruar me urdhërin nr. 15 datë 10.02.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist Jurist në Drejtorinë Juridike dhe Trajtimit Ligjor të Pronave”, emëruar me urdhërin nr. 30 datë 17.02.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist i burimeve njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, emëruar me urdhërin nr. 26 datë 17.02.2021;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave”, emëruar me urdhërin nr. 124 datë 01.07.2021.

Komisioneri konstaton se, akti i emërimit, për punonjësit e evidentuar më sipër, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të neneve 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Finiq, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve duke rregulluar pasojat nëpërmjet ndërprjes së marrëdhënies së punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, për rastet e pozicioneve

të lira në institucion, në përputhje me nevojat e strukturës që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

Në momentin e verifikimit, në Bashkinë Finiq, rezulton se **9** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, janë vende të lira, të evidentuara si më poshtë:

- ✓ *Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Trajtimin Ligjor të Pronave;*
- ✓ *Specialist Kontabiliteti dhe i Pagave në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Financës;*
- ✓ *Specialist i Vlerësimit, Planifikimit të të Ardhurave dhe Rakordimit të Taksave në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike;*
- ✓ *2 pozicione të kategorisë Specialist Inxhinier Pyjesh në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave;*
- ✓ *Specialist i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Sektorit të AMT në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave*
- ✓ *Përgjegjës Sektori në Sektorin e AMT në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave;*
- ✓ *Specialist Topograf në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Specialist Hartograf në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*

Nga ana tjetër, evidentohet nevoja për të rishikuar përshkrimet e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, me qëllim që të përditësohen me ndryshimet e strukturës dhe kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që në bashkëpunim me nëpunësit civilë përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës në këtë institucion, të analizojnë përshkrimet aktuale të punës sipas strukturës së institucionit dhe të vendosin përfundimisht për pozicionet e punës që do të jenë pjesë e shërbimit civil, në përputhje

me detyrat funksionle të tyre dhe me kërkesat specifike të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që e rregullojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil (vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Gjatë këtij procesi të rakordohen veprimet edhe me përfaqësuesit e Komisionerit me qëllim që të përcaktohen saktë pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, me objektivin për të krijuar një strukturë të qëndrueshme dhe funksionale në këtë institucion.

2. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Finiq, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **28** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
3. Njësia përgjegjëse të planifikojë dhe të shpallë shpallë për t’u plotësuar pozicionet e lira në shërbimin civil, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi, e më tej të vijojnë procedurat konkurrimit, duke u kujdesur që të realizojë procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive, brenda kohës që do të përcaktohet në këtë vendim paralajmërimi.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2022, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Finiq, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkëlqeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Finiq, Prefekti i Qarkut Vlorë dhe Ministria e Brendshme. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Finiq të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë akt.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**